REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

P R O J E K T L I G J

Nr. _____/2026

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 27/2018 "PËR TRASHËGIMINË KULTURORE DHE MUZETË", I NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime

Neni 1

Në nenin 5 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.Pika 26 ndryshon si vijon:

[1]Ky ligj përafrohet pjesërisht me:
- Rregulloren (KE) nr. 116/2009 të Këshillit, datë 18 dhjetor 2008, "Për eksportin e mallrave kulturore" (versioni i kodifikuar), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 39, datë 10.2.2009, faqe 1. Numri CELEX: 32009R0116;
- Rregulloren zbatuese (BE) nr. 1081/2012 të Komisionit, datë 9 nëntor 2012, "Për qëllime të Rregullores (KE) nr. 116/2009 të Këshillit për eksportin e mallrave kulturore", Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 324, datë 22.11.2012, faqe 1. Numri CELEX: 32012R1081;
- Rregulloren (BE) 2019/880 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 17 prill 2019, "Për hyrjen dhe importin e mallrave kulturore", Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 151, datë 7.6.2019, faqe 1. Numri CELEX: 32019R0880;
- Rregulloren zbatuese (BE) 2021/1079 të Komisionit, datë 24 qershor 2021, "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zbatimin e disa dispozitave të Rregullores (BE) 2019/880 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit për hyrjen dhe importin e mallrave kulturore", Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 234, datë 2.7.2021, faqe 67. Numri CELEX: 32021R1079;
- Direktivën 2014/60/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, "Për kthimin e objekteve kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar dhe që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 1024/2012 (Rishikim)", Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 159, datë 28.5.2014, faqe 1. Numri CELEX: 32014L0060.

“26. “Konservimi parandalues” është tërësia e masave dhe veprimeve që synojnë parandalimin ose minimizimin e degradimit apo dëmtimit të pasurive kulturore materiale, nëpërmjet krijimit dhe ruajtjes së kushteve të përshtatshme mjedisore (lagështi relative, temperaturë,pastërti nga ndotja atmosferike, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti),, pa ndërhyrë drejtpërdrejt në materialet, strukturën dhe pamjen e tyre.”

2. Pika 33 ndryshon si vijon:

33. "Mirëmbajtja" është tërësia e masave dhe veprimeve të rregullta e të vazhdueshme të kujdesit mbrojtës ndaj pasurisë kulturore dhe zonës mbrojtëse të saj, që synojnë parandalimin e degradimit dhe ruajtjen e vlerave të saj kulturore. Mirëmbajtja ka karakter parandalues dhe kryhet pa cenuar autenticitetin, integritetin dhe elementet që mbartin vlerat kulturore të pasurisë.”

3. Pika 37 ndryshon si vijon:

37. “Muzeu është një institucion i përhershëm, jofitimprurës, në shërbim të shoqërisë, që kërkon, mbledh, konservon, interpreton dhe ekspozon trashëgiminë materiale dhe jomateriale. I hapur për publikun, i aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës, muzeu nxit diversitetin dhe qëndrueshmërinë. Ai vepron dhe komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, me pjesëmarrjen e komuniteteve, duke ofruar përvoja të larmishme për edukim, kënaqësi, reflektim dhe shkëmbim njohurish.”

4. Pika 46. Ndryshon si vijon:

46. “Plani i menaxhimit” është dokumenti strategjik dhe operacional që përcakton objektivat, masat, përgjegjësitë, burimet dhe mekanizmat e monitorimit për mbrojtjen, konservimin, përdorimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pasurisë kulturore, duke garantuar ruajtjen e vlerave, autenticitetit dhe integritetit të saj.”

5. Pika 47 shfuqizohet.

6. Pika 50 ndryshon si vijon:

50. “Restaurimi” është ndërhyrja e specializuar në një pasuri kulturore materiale, që synon ndalimin e degradimit, ruajtjen dhe evidentimin e vlerave të saj kulturore, duke respektuar autenticitetin, integritetin dhe materialin origjinal, mbi bazën e studimit dhe dokumentimit shkencor e teknik.”

7. Pas pikës 67 shtohen pikat 68 deri në 80 me këtë përmbajtje:

68. "Deklaratë e importuesit" është deklarata e nënshkruar nga poseduesi i objekteve kulturore, e shoqëruar me dokumentacionin sipas parashikimeve ligjore.

69. “Dokument që provon vendin e origjinës për objektet kulturore të importuara”, në kuptim të këtij ligji, Konventës së UNESCO-s së vitit 1970 “Mbi Mjetet e Ndalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronës Kulturore” dhe Direktivës 2014/60/BE, është çdo provë shkresore, shkencore ose zyrtare që dëshmon lidhjen materiale, historike ose arkeologjike të një objekti kulturor me territorin e një shteti të caktuar, dhe që mbështet kërkesën për mbrojtje, kontroll ose rikthim të këtij objekti.

70. "Eksport i objekteve kulturore" është dalja, e përhershme ose e përkohshme, e një objekti kulturor nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

71. "Hyrje e objekteve kulturore" është çdo hyrje në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë e objekteve kulturore që i nënshtrohen mbikëqyrjes ose kontrollit doganor, sipas Kodit Doganor.

72. *“Importi i objekteve kulturore”, në kuptim të këtij ligji, nënkupton hyrjen e përhershme ose të përkohshme të një objekti të trashëgimisë kulturore në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga një shtet tjetër.*

73. *"Lëvizja e paligjshme e pasurisë kulturore" është: a) largimi i një pasurie kulturore nga territori i një shteti në shkelje të legjislacionit të atij shteti për mbrojtjen e pasurive kulturore ose në shkelje të kushteve të licencës së eksportit;b) moskthimi i pasurisë kulturore në përfundim të periudhës së daljes së përkohshme të ligjshme, ose shkelja e çdo kushti tjetër që rregullon daljen e përkohshme.*

74. "Licencë eksporti" është akti administrativ i lëshuar nga zyra për çështjet e import-eksportit pranë IKRTK-së, që lejon eksportin e objekteve kulturore.

75. "Licencë importi" është akti administrativ i lëshuar nga zyra për çështjet e import-eksportit pranë IKRTK-së, që lejon importin e objekteve kulturore.

76. "Mbajtës" është personi fizik ose juridik, publik ose privat, që mban fizikisht pasurinë kulturore për llogari të të tretëve.

77. "Posedues" është personi fizik ose juridik, publik ose privat, që mban fizikisht pasurinë kulturore për llogari të vet.

78. "Shtet kërkues" është shteti nga territori i të cilit pasuria kulturore është larguar në mënyrë të paligjshme.

79. “Shteti të cilit i kërkohet rikthimi i objektit pasuri kulturore” është shteti në territorin e të cilit ndodhet një objekt kulturor, i cili është larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti tjetër.

80. "Vend i krijimit ose i zbulimit" është vendi në territorin e të cilit objektet kulturore janë krijuar ose zbuluar, në tokë ose nën ujë.

81. Veprimtari në fushën e trashëgimisë kulturore janë aktivitete dhe nisma që lidhen drejtpërdrejt me studimin, dokumentimin, promovimin, trajnimin, digjitalizimin, ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.”

Neni 2

Kudo në ligj, emërtimet *"zyra e eksportit"* dhe *"zyra për çështjet e eksportit"* zëvendësohen me emërtimin *"zyra për çështjet e import-eksportit"*.

Neni 3

Neni 9 ndryshon si më poshtë:

“Neni 9

Politikat në fushën e trashëgimisë kulturore

1. Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet dhe përparësitë e përgjithshme të politikave shtetërore në fushën e trashëgimisë kulturore. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore harton, propozon, bashkërendon dhe monitoron zbatimin e këtyre politikave, në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore dhe subjektet e interesuara, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, sipas përcaktimeve të këtij ligji Këshilli i Ministrave:

a) krijon, riorganizon ose mbyll institucione dhe subjekte juridike të parashikuara nga ky ligj, në fushën e trashëgimisë kulturore, si dhe përcakton, ndryshon ose rishpërndan kompetencat, funksionet dhe organizimin e tyre, dhe në përputhje me legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;

b) krijon, riorganizon dhe mbyll muzetë publikë qendrorë dhe qendrat muzeore;

c) përcakton përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e organeve kolegjiale në fushën e trashëgimisë kulturore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ç) miraton planet e menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara dhe planet për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre;

d) vendos për kalimin në administrim të pasurive kulturore të paluajtshme "të vetme";

dh)deklaron "pasuri kulturore" pasuritë e paluajtshme të grupuara;

e) ushtron kompetencat e tjera të përcaktuara në këtë ligj."

Neni 4

Në nenin 18, pas fjalisë së parë shtohet:

"Procedurat, kriteret, rregullat e propozimit, vlerësimit dhe financimit të këtyre veprimtarive përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore."

Neni 5

Në nenin 19, pika 2, shkronja "a" bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2, a) bëhen këto ndryshime si më poshtë:

"2. a) Të ardhurat e krijuara nga shërbimet dhe përdorimi i pasurive kulturore në administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucioneve të saj të varësisë;

2. Pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

4. Kriteret, procedurat e administrimit dhe përdorimi i të ardhurave të përcaktuara në shronjën "a", të pikës 2 përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore."

Neni 6

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Projektet e propozuara i nënshtrohen vlerësimit teknik dhe miratimit nga organet kompetente, sipas këtij ligji. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore miraton financimin e tyre, brenda fondeve buxhetore të miratuara. Për ndërhyrjet e ruajtjes dhe restaurimit, prioritetet përcaktohen në bazë të rëndësisë kulturore të pasurisë, nivelit të riskut, urgjencës së ndërhyrjes dhe ndikimit të pritshëm. IKTK-ja, në bashkëpunim me DRTK-të dhe institucionet administruese, harton dhe përditëson çdo vit

listën e pasurive në risk dhe të ndërhyrjeve prioritare, e cila shërben si bazë për planifikimin e financimit të këtyre ndërhyrjeve."

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Të ardhurat e krijuara nga shërbimet dhe përdorimi i pasurive kulturore në administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të institucioneve të saj të varësisë ndahen në masën 90 për qind për ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe në masën 10 për qind sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor. Nga pjesa prej 90 për qind, një pjesë përdoret për funksionimin, mirëmbajtjen, sigurinë, konservimin, administrimin e koleksioneve dhe shërbimet për publikun të institucioneve që krijojnë këto të ardhura, ndërsa pjesa tjetër transferohet në Fondin Kombëtar të parashikuar në nenin 19 të këtij ligji. Kriteret dhe përqindjet e shpërndarjes së pjesës prej 90 për qind ndërmjet institucioneve dhe Fondit Kombëtar, si dhe procedurat për planifikimin, përdorimin, transferimin dhe raportimin e saj, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor."

Neni 7

Pas nenit 20 shtohet neni 20/1 , 20/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 20/1

Mbështetja financiare për pasuritë kulturore në pronësi jopublike

1. Brenda fondeve buxhetore të miratuara, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mund të mbështesë financiarisht ruajtjen, mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturore në pronësi jopublike, nëpërmjet granteve, bashkëfinancimit ose kontributit në natyrë.

2. Mbështetja financiare u jepet pronarëve ose poseduesve të ligjshëm të pasurive kulturore, në përputhje me procedurat për miratimin e ndërhyrjeve dhe dispozitat përkatëse të këtij ligji. Përfitimi i mbështetjes financiare nuk përjashton detyrimin për marrjen e miratimeve dhe autorizimeve të parashikuara nga ky ligj.

3. Për ndërhyrjet vullnetare, masa dhe kushtet e kontributit financiar të ministrisë përcaktohen sipas nenit 89 të këtij ligji, ndërsa mënyra e shlyerjes së tij sipas nenit 94. Ndërhyrjet e detyruara ruajtëse financohen dhe realizohen në përputhje me nenet 90 deri në 94 të këtij ligji.

4. Shpenzimet e pranueshme përfshijnë dokumentimin, studimet, projektimin, punimet për ruajtjen, konservimin dhe restaurimin, si dhe mbikëqyrjen dhe kolaudimin e tyre. Nuk financohen punime që nuk lidhen drejtpërdrejt me ruajtjen e vlerave kulturore të pasurisë.

5. Mbështetja financiare nuk përjashton pronarin ose poseduesin e ligjshëm nga detyrimet që i ngarkon ky ligj për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë kulturore.

6. Mbështetja mund të jepet edhe në formën e kontributit në natyrë, nëpërmjet hartimit të projektit të ndërhyrjes, ofrimit të shërbimeve të tjera të specializuara, materialeve ose mjeteve nga institucionet publike, në përputhje me kompetencat e tyre dhe legjislacionin për menaxhimin financiar publik. Vlera e kontributit në natyrë dokumentohet dhe përfshihet në vlerën e përgjithshme të mbështetjes publike, pa tejkaluar kufijtë e parashikuar në këtë ligj.

7. Përfituesi është përgjegjës për përdorimin e mbështetjes sipas qëllimit të miratuar, dokumentimin e shpenzimeve dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore për ruajtjen e pasurisë kulturore."

Neni 8

Në nenin 31, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore, në vijim DRTK-të, janë institucione publike rajonale të specializuara, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, që ushtrojnë funksione teknike dhe administrative për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e trashëgimisë kulturore materiale në territorin e juridiksionit të tyre."

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. DRTK-të ushtrojnë funksionet e tyre në varësi administrative dhe buxhetore të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore siguron mbështetjen dhe bashkërendimin tekniko-shkencor të veprimtarisë së DRTK-ve, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë ligj, pa cenuar varësinë e tyre institucionale."

3. Në pikën 4, shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) bashkëpunojnë me institucionet përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, brenda fushës së kompetencës së tyre;"

4. Në pikën 4, shkronja "e" ndryshohet si më poshtë:

"e) kryejnë mbikëqyrjen teknike dhe kolaudimin e punimeve në pasuritë kulturore materiale, sipas legjislacionit në fuqi, duke respektuar kërkesat për ndarjen e funksioneve dhe shmangien e konfliktit të interesit;"

5. Në pikën 4, pas shkronjës "e" shtohen shkronjat "ë/1", "ë/2", "ë/3" dhe "ë/4", me këtë përmbajtje:

"ë/1) administrojnë dhe mirëmbajnë pasuritë kulturore dhe parqet arkeologjike që u janë ngarkuar në administrim, në përputhje me aktet përkatëse dhe planet e miratuara të menaxhimit;

ë/2) dokumentojnë gjendjen e ruajtjes së pasurive kulturore, faktorët e riskut dhe ndërhyrjet e kryera, si dhe përcjellin informacionin përkatës pranë institucioneve përgjegjëse, sipas kompetencave të tyre;

ë/3) evidentojnë shkeljet e dyshuara të legjislacionit për trashëgiminë kulturore, të konstatuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, dhe i referojnë ato pranë strukturës përgjegjëse për inspektimin, duke vënë në dispozicion dokumentacionin dhe informacionin teknik përkatës;

ë/4) bashkëpunojnë me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e specializuara dhe subjektet e tjera publike e private për mbrojtjen, ruajtjen, promovimin dhe edukimin nëpërmjet trashëgimisë kulturore."

6. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. DRTK-të bashkëpunojnë me Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për sigurimin dhe përditësimin e dokumentacionit dhe të dhënave për pasuritë kulturore. Për çështjet e trashëgimisë kulturore jomateriale, DRTK-të bashkëpunojnë me Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale."

7. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

"7. Organizimi, funksionimi, juridiksioni territorial dhe mënyra e ushtrimit të detyrave të DRTK-ve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Struktura dhe organika e tyre miratohen me urdhrin e Kryeministrit."

Neni 9

Në nenin 32, pika 6, riformulohet si vijon:

"6. Pranë IKRTK funksionon zyra për çështjet e import-eksportit të pasurive kulturore të luajtshme, në përputhje me parashikimet e këtij ligji për zbatimin dhe monitorimin e procedurave të importit dhe eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombëtar të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit."

Neni 10

1.Në nenin 38 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "d" e pikës 2, ndryshohet si më poshtë:

"d) të shqyrtojë propozimin për deklarimin e interesit kulturor ose mungesën e tij për pasuritë kulturore materiale të paluajtshme të vetme dhe të grupuara;"

2. Shkronja "e" e pikës 2, ndryshohet si më poshtë:

"e) të shprehet me vendim mbi dokumentet me karakter të përgjithshëm që lidhen me ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale;"

Neni 11

1.Pas nenit 42 shtohet neni 42/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 42/1

Vlerësimi i ndikimit në trashëgiminë kulturore

1. Vlerësimi i ndikimit në trashëgiminë kulturore (VNT) është është procesi i identifikimit, analizimit dhe vlerësimit të ndikimeve të mundshme të planeve, programeve, projekteve ose ndërhyrjeve mbi pasuritë kulturore të paluajtshme, vlerat dhe atributet e tyre, autenticitetin, integritetin dhe kontekstin përkatës, me qëllim shmangien ose zbutjen e ndikimeve negative.

2. VNT-ja kërkohet për planet, programet, projektet dhe ndërhyrjet që mund të ndikojnë mbi:

a) pasuritë e përfshira në Listën e Trashëgimisë Botërore, zonat e tyre mbrojtëse, Vlerën Universale të Jashtëzakonshme dhe atributet që e mbartin atë;

b) pasuritë kulturore të paluajtshme, të vetme ose të grupuara, dhe zonat e tyre mbrojtëse, kur mund të shkaktohen ndikime negative të konsiderueshme, sipas regjimeve përkatëse të mbrojtjes.

3. Nevoja për kryerjen e VNT-së përcaktohet nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), nëpërmjet shqyrtimit paraprak të natyrës, përmasave, vendndodhjes dhe ndikimeve të mundshme të planit, programit, projektit ose ndërhyrjes, sipas kritereve të përcaktuara në aktin nënligjor të nxjerrë

në zbatim të këtij neni. Për pasuritë e përfshira në Listën e Trashëgimisë Botërore vlerësohet, në mënyrë të posaçme, çdo ndikim i mundshëm mbi Vlerën Universale të Jashtëzakonshme dhe atributet që e mbartin atë.

4. VNT-ja kryhet në fazat e hershme të planifikimit dhe përpara vendimmarrjes për miratimin e planit, programit, projektit ose ndërhyrjes. Vlerësimi përfshin identifikimin e vlerave dhe atributeve të pasurisë, ndikimet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe kumulative, shqyrtimin e alternativave, përfshirë alternativën e mosrealizimit, si dhe masat për shmangien, zbutjen dhe monitorimin e ndikimeve negative.

5. VNT-ja hartohet nga individë ose subjekte të licencuara sipas këtij ligji, me kualifikimet përkatëse në fushën e trashëgimisë kulturore, duke garantuar pavarësinë profesionale dhe shmangien e konfliktit të interesit.

6. VNT-ja shqyrtohet nga institucionet dhe organet kompetente, sipas këtij ligji, duke përfshirë, sipas fushës së përgjegjësisë, institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore. Procesi i vlerësimit siguron konsultimin e palëve të interesuara dhe komuniteteve të prekura, në përputhje me natyrën dhe ndikimet e mundshme të planit, programit, projektit ose ndërhyrjes.

7. Për pasuritë e përfshira në Listën e Trashëgimisë Botërore, VNT-ja vlerëson në mënyrë të posaçme ndikimet mbi Vlerën Universale të Jashtëzakonshme dhe atributet që e mbartin atë, përfshirë autenticitetin dhe integritetin. Njoftimi dhe përcjellja e dokumentacionit pranë Qendrës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s kryhen përpara marrjes së vendimeve të pakthyeshme, në përputhje me Konventën e Trashëgimisë Botërore dhe Udhëzimet Operacionale për zbatimin e saj.

8. Përfundimet dhe rekomandimet e VNT-së merren në konsideratë në vendimmarrjen për planin, programin, projektin ose ndërhyrjen. Miratimi nuk jepet kur ndikimet e identifikuara, edhe pas shqyrtimit të alternativave dhe masave për shmangien ose zbutjen e tyre, mbeten në kundërshtim me regjimin ligjor të mbrojtjes së pasurisë. Vendimi arsyeton mënyrën e trajtimit të përfundimeve dhe rekomandimeve të VNT-së.

9. Kriteret për përcaktimin e rasteve që kërkojnë VNT, metodologjia, formati dhe përmbajtja e raportit, procedurat e shqyrtimit dhe bashkërendimi me vlerësimin e ndikimit në mjedis ose vlerësimin strategjik mjedisor përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me legjislacionin përkatës".

Neni 12

Në nenin 49 pas pikës 5, shtohet pika 6-7 me përmbajtje si vijon:

"6. Në rast se pronari, poseduesi ose administruesi i pasurisë kulturore të paluajtshme nuk merr pjesë në procedurën e marrjes në dorëzim të punimeve, pavarësisht se është njoftuar rregullisht, sipas legjislacionit për procedurat administrative, të paktën 7 ditë pune përpara datës së caktuar, komisioni vijon procedurën në mungesë të tij. Mosparaqitja dokumentohet në procesverbal. Një kopje e procesverbalit dhe e dokumentacionit të marrjes në dorëzim i njoftohet pronarit, poseduesit ose administruesit, sipas legjislacionit për procedurat administrative. Marrja në dorëzim e punimeve nuk cenon pronësinë, të drejtat reale ose statusin juridik të pasurisë kulturore.

7. Kur pasuria kulturore është në pronësi shtetërore dhe nuk është në administrim të një institucioni shtetëror, në procedurën e marrjes në dorëzim të punimeve merr pjesë titullari i institucionit rajonal përgjegjës për trashëgiminë kulturore ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Pjesëmarrja në këtë

procedurë nuk sjell kalimin e së drejtës së administrimit apo përgjegjësive që lidhen me pronësinë mbi pasurinë."

Neni 13

Në nenin 50 pas pikës 4 shtohet një pikë 5 me përmbajtjen si vijon:

"5. Kategoritë e pasurive kulturore të luajtshme që i nënshtrohen procedurave të importit dhe eksportit, si dhe kriteret për vjetërsinë dhe vlerën monetare përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore."

Neni 14

Në nenin 56, pika 8 ndryshohet si më poshtë:

"8. Informacioni i përftuar nëpërmjet proceseve të identifikimit, dokumentimit, inventarizimit, regjistrimit dhe katalogimit të trashëgimisë kulturore përfshihet dhe administrohet në bazën shtetërore të të dhënave të pasurive kulturore, në përputhje me legjislacionin për bazat e të dhënave shtetërore, mbrojtjen e të dhënave personale dhe dispozitat e këtij ligji."

Neni 15

Neni 57 ndryshon si më poshtë:

"Neni 57

Verifikimi i interesit kulturor

"1. Verifikimi i interesit kulturor kryhet për të përcaktuar ekzistencën ose mungesën e vlerave artistike, historike, arkeologjike, etnografike ose të vlerave të tjera kulturore të pasurive, sipas kategorive, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë ligj, veçanërisht në nenet 50, 53, 54 dhe 55 të tij.

2. Verifikimi i interesit kulturor kryhet nga institucionet e specializuara, sipas kategorisë së pasurisë, si më poshtë:

a) nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore (DRTK), për pasuritë kulturore të paluajtshme, të vetme dhe të grupuara;

b) nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), në bashkëpunim, sipas rastit, me IKTK-në, DRTK-të, institucionet administruese të parqeve arkeologjike dhe muzetë kombëtarë, për pasuritë kulturore të luajtshme;

c) nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale (QKVT), në bashkëpunim me DRTK-të dhe komunitetet, grupet dhe individët bartës, për trashëgiminë kulturore jomateriale.

3. Për kryerjen e verifikimit, IKTK-ja, IKRTK-ja dhe QKVT-ja mund të angazhojnë, sipas nevojës, ekspertë të jashtëm nga institucione të specializuara, institucione shkencore dhe universitete, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Verifikimi kryhet mbi bazën e dokumentacionit, të dhënave shkencore dhe teknike, verifikimit në terren dhe kritereve të vlerësimit, sipas natyrës së pasurisë. Për trashëgiminë kulturore jomateriale, verifikimi mbështetet në procesin e identifikimit dhe dokumentimit, me pjesëmarrjen aktive të komuniteteve, grupeve dhe individëve bartës, në përputhje me parimet e Konventës së UNESCO-s të vitit 2003 për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale.

5. Rezultati i verifikimit dokumentohet në një raport vlerësimi, i cili përbën bazën për propozimin për deklarimin e interesit kulturor ose mungesën e tij, sipas këtij ligji".

Neni 16

Neni 58 ndryshon si më poshtë:

"Neni 58

Procedura e verifikimit të interesit kulturor

1. Procedura e verifikimit fillon me nismën e institucionit kompetent ose me kërkesë të pronarit, poseduesit, njësisë së vetëqeverisjes vendore, institucionit publik ose privat, komunitetit bartës apo çdo subjekti tjetër të interesuar që paraqet të dhëna për ekzistencën e interesit kulturor.

2. Kërkesa paraqitet pranë institucionit kompetent, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 57 të këtij ligji, dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës për identifikimin dhe vlerësimin e pasurisë.

3. Institucioni kompetent shqyrton dokumentacionin, kryen verifikimet e nevojshme dhe harton raportin e vlerësimit, në të cilin përcaktohen:

a) identifikimi dhe përshkrimi i pasurisë ose i elementit të trashëgimisë kulturore materiale ose jomateriale;

b) vlerat kulturore të evidentuara dhe arsyetimi për ekzistencën ose mungesën e interesit kulturor;

c) propozimi për kategorinë dhe statusin e mbrojtjes, kur nga verifikimi rezulton ekzistenca e interesit kulturor;

ç) nevoja për masa mbrojtëse paraprake, kur është e zbatueshme;

d) për trashëgiminë kulturore jomateriale, dokumentimi i pjesëmarrjes së komuniteteve, grupeve dhe individëve bartës, i njohjes prej tyre të elementit si pjesë e trashëgimisë së tyre kulturore dhe i pëlqimit të lirë, paraprak dhe të informuar për procesin e deklarimit.

4. Procedura e verifikimit përfundon me akt të arsyetuar të titullarit të institucionit kompetent, bazuar në raportin e vlerësimit, brenda 120 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës së plotë ose nga fillimi kryesisht i procedurës. Në raste të veçanta, për shkak të kompleksitetit të verifikimit, ky afat mund të zgjatet deri në 60 ditë kalendarike, me akt të arsyetuar të titullarit, duke njoftuar subjektet e interesuara.

5. Kur nga verifikimi rezulton ekzistenca e interesit kulturor, institucioni kompetent përgatit propozimin për deklarimin e interesit kulturor, së bashku me raportin e vlerësimit dhe dokumentacionin përkatës, dhe e përcjell për shqyrtim pranë këshillit kombëtar përkatës, sipas neneve 62 dhe 64 të këtij ligji.

6. Kur nga verifikimi rezulton mungesa e interesit kulturor, institucioni kompetent përcjell raportin e vlerësimit dhe dokumentacionin përkatës për shqyrtim pranë këshillit kombëtar përkatës. Mungesa e

interesit kulturor nuk cenon regjimet e tjera të mbrojtjes që mund të zbatohen për pasurinë sipas legjislacionit në fuqi.
7. Kur ekziston rreziku i dëmtimit, tjetërsimit ose humbjes së pasurisë kulturore materiale, institucioni kompetent mund të vendosë mbrojtjen paraprake të saj, me akt të arsyetuar, deri në përfundimin e procedurës së deklarimit, por jo më shumë se 180 ditë. Akti përcakton masat përkatëse të mbrojtjes, të cilat zbatohen nga njoftimi i tij, dhe i njoftohet pronarit ose poseduesit, si dhe institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen dhe regjistrimin.
8. Para përfundimit të procedurës, pronarit ose poseduesit të pasurisë kulturore materiale i garantohet e drejta për t'u njohur me dokumentacionin dhe për të paraqitur vërejtje, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
9. Për verifikimin e dokumenteve arkivore zbatohen dispozitat e legjislacionit të posaçëm për arkivat.

Neni 17

Neni 59
Shfuqizohet

Neni 18

Neni 60
Shfuqizohet

Neni 19

Në nenin 61, bëhen ndryshimet si më poshtë:
1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:
"1. Deklarimi i pasurisë kulturore materiale bëhet mbi bazën e rezultatit pozitiv të verifikimit të interesit kulturor, sipas neneve 57 dhe 58 të këtij ligji, dhe pas miratimit në parim nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), sipas procedurës së përcaktuar në nenin 62 të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon mbrojtjen e pasurisë pa deklarim.

2. Pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Objektet e deklaruara pasuri kulturore sipas përcaktimeve të këtij neni mund të klasifikohen njëherësh si thesar kombëtar, sipas nenit 5, pika 57, e këtij ligji, kur plotësojnë kriteret e nenit 54, pika 4, të këtij ligji."

Neni 20

Neni 62 ndryshon si më poshtë:

Neni 62

Procedura e deklarimit të pasurive kulturore materiale

"1. Propozimi për deklarimin e interesit kulturor të pasurive kulturore materiale i paraqitet për shqyrtim dhe miratim në parim Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), si më poshtë:

a) nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), për pasuritë kulturore të paluajtshme, të vetme dhe të grupuara;
b) nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), për pasuritë kulturore të luajtshme, përfshirë koleksionet.
2. Propozimi shoqërohet me aktin e përfundimit të verifikimit, raportin e vlerësimit dhe dokumentacionin teknik përkatës. Për pasuritë kulturore të paluajtshme, dokumentacioni përfshin, sipas rastit, propozimin për kufijtë, zonën mbrojtëse, kategorinë dhe regjimin e mbrojtjes.
3. KKTKM-ja shqyrton propozimin dhe dokumentacionin shoqërues dhe vendos për miratimin ose mosmiratimin në parim të deklarimit të interesit kulturor. Vendimi arsyetohet dhe i përcillet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.
4. Pas miratimit në parim nga KKTKM-ja, deklarimi i interesit kulturor bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me përjashtim të pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, deklarimi i të cilave bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
5. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore përfundon procedurën e deklarimit brenda 45 ditëve nga marrja e vendimit të miratimit në parim nga KKTKM-ja dhe e dokumentacionit të plotë. Për pasuritë kulturore të paluajtshme të grupuara, brenda këtij afati ministria përgatit dhe paraqet propozimin për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.
6. Akti i deklarimit përcakton identifikimin e pasurisë, vlerat kulturore të mbrojtura, kategorinë dhe statusin e mbrojtjes, si dhe, për pasuritë kulturore të paluajtshme, kufijtë, zonën mbrojtëse dhe regjimin përkatës të mbrojtjes, sipas këtij ligji.
7. Akti i deklarimit i njoftohet pronarit ose poseduesit, sipas rastit, dhe i përcillet IKRTK-së për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj."

Neni 21

Neni 63 ndryshon si më poshtë:

"Neni 63

Deklarimi i interesit kulturor për koleksionet

1. Deklarimi i interesit kulturor për koleksionet bëhet me propozimin e IKRTK-së, sipas procedurës së përcaktuar në nenet 57, 58 dhe 62 të këtij ligji, duke marrë në konsideratë vlerën kulturore të koleksionit në tërësi."

Neni 22

Neni 64 ndryshon si më poshtë:

"Neni 64

Deklarimi i interesit kulturor të pasurive jomateriale

1. Deklarimi i interesit kulturor të trashëgimisë kulturore jomateriale bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas miratimit në parim nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (KKTKJ).

2. Propozimi për deklarim përgatitet nga QKVT-ja, në bashkëpunim me DRTK-të dhe komunitetet, grupet dhe individët bartës, mbi bazën e një procesi identifikimi, verifikimi dhe dokumentimi, me pjesëmarrjen e tyre aktive, në përputhje me parimet e Konventës së UNESCO-s të vitit 2003 për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale.
3. Propozimi shoqërohet me raportin e vlerësimit dhe dokumentacionin përkatës, që përmban identifikimin dhe përshkrimin e elementit të trashëgimisë kulturore jomateriale, vlerat kulturore të tij, komunitetet, grupet dhe individët bartës, pjesëmarrjen e tyre në procesin e identifikimit dhe dokumentimit, pëlqimin e lirë, paraprak dhe të informuar për deklarimin, si dhe nevojat dhe masat e propozuara për ruajtjen dhe transmetimin e elementit.
4. KKTKJ-ja shqyrton propozimin dhe dokumentacionin shoqërues, duke vlerësuar veçanërisht përmbushjen e kritereve të interesit kulturor, pjesëmarrjen e komuniteteve, grupeve dhe individëve bartës dhe respektimin e parimeve të Konventës së UNESCO-s të vitit 2003, dhe vendos për miratimin ose mosmiratimin në parim të deklarimit.
5. Pas miratimit në parim nga KKTKJ-ja, deklarimi i interesit kulturor bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
6. Elementi i deklaruar regjistrohet nga IKRTK-ja në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore Jomateriale, në bashkëpunim me QKVT-në".

Neni 23

Neni 65 ndryshon si më poshtë:

"Neni 65

Njoftimi i deklarimit

1. Akti i deklarimit të interesit kulturor të pasurisë kulturore materiale i njoftohet, sipas rastit, IKTK-së, DRTK-së përgjegjëse për territorin, pronarit ose poseduesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Për trashëgiminë kulturore jomateriale, akti i deklarimit të interesit kulturor i njoftohet QKVT-së, komuniteteve, grupeve dhe individëve bartës, si dhe subjektit kërkues, sipas rastit.

3. Akti i deklarimit të interesit kulturor i përcillet IKRTK-së për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore, sipas kategorisë përkatëse të pasurisë.

4. Për pasuritë kulturore të paluajtshme, IKRTK-ja bashkërendon me IKTK-në për pasqyrimin e deklarimit dhe përditësimin e dokumentacionit dhe të të dhënave teknike të pasurisë në regjistrat dhe sistemet ËEBGIS që administron IKTK-ja.

5. Për trashëgiminë kulturore jomateriale, IKRTK-ja bashkërendon me QKVT-në për pasqyrimin e deklarimit dhe përditësimin e regjistrave dhe listave përkatëse që administron QKVT-ja, sipas nenit 33 të këtij ligji".

Neni 24

Pas nenit 70 shtohet neni 70/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 70/1

Vlerësimi financiar i pasurive kulturore të luajtshme

1. Pasuritë kulturore të luajtshme mund t'i nënshtrohen vlerësimit financiar për përcaktimin ose përditësimin e vlerës së tyre monetare, si dhe për përcaktimin e kësaj vlere për një qëllim të caktuar, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.
2. Vlerësimi financiar mund të kryhet, ndër të tjera, për qëllime të huapërdorjes, sigurimit, garancisë shtetërore, përcaktimit të garancive financiare, përcaktimit të dëmshpërblimit në rast dëmtimi, humbjeje ose shkatërrimi, lëvizjes së përkohshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe në raste të tjera kur nevojitet përcaktimi i vlerës monetare të pasurisë.
3. Vlerësimi financiar kryhet nga ekspertë me kualifikimin përkatës, sipas natyrës dhe kategorisë së pasurisë kulturore, duke garantuar paanshmërinë dhe shmangien e konfliktit të interesit. Në rastet e përcaktuara me aktin nënligjor të parashikuar në pikën 6 të këtij neni, vlerësimi kryhet nga ekspertë të pavarur ose i nënshtrohet një vlerësimi të dytë.
4. Vlerësimi financiar mbështetet në dokumentacionin e pasurisë, autenticitetin, rëndësinë kulturore, gjendjen e ruajtjes, prejardhjen, kufizimet ligjore të qarkullimit, si dhe në kriteret e tjera përkatëse, sipas natyrës së pasurisë dhe qëllimit të vlerësimit. Pamundësia për përcaktimin e vlerës monetare nuk cenon statusin, regjistrimin ose mbrojtjen juridike të pasurisë kulturore.
5. Vlera monetare përcaktohet në raportin e vlerësimit financiar dhe mund të përditësohet ose të rivlerësohet kur ndryshojnë rrethanat ose kur kjo kërkohet për një qëllim të caktuar. Raporti i vlerësimit financiar ruhet në dokumentacionin e pasurisë kulturore. Ai nuk përbën titull pronësie dhe nuk autorizon tjetërsimin, eksportimin ose kryerjen e veprimeve të tjera të kufizuara nga ky ligj.
6. Metodologjia e vlerësimit financiar, kriteret profesionale të ekspertëve, rastet dhe periodiciteti i përditësimit ose rivlerësimit, rastet kur kërkohet ekspertizë e pavarur ose vlerësim i dytë, përmbajtja e raportit të vlerësimit financiar dhe procedura e vlerësimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat."

Neni 25

Në nenin 77 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia:

"Për mirëmbajtjen zbatohet procedura e parashikuar në pikën 2/1 të këtij neni."

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

"2/1. Mirëmbajtja kryhet sipas një procedure të thjeshtuar pranë DRTK-së dhe nuk kërkon leje të veçantë të KKTKM-së. Përpara fillimit të punimeve, pronari ose administruesi paraqet përshkrimin e punimeve, dokumentacionin fotografik dhe të dhënat e personit që do t'i kryejë ato. DRTK-ja, brenda 10 ditëve pune nga paraqitja e dokumentacionit të plotë, verifikon përputhshmërinë e punimeve me përkufizimin e parashikuar në pikën 33 të nenit 5 të këtij ligji dhe lëshon aktin teknik me kushtet përkatëse ose përcakton se ndërhyrja i nënshtrohet procedurës së zakonshme të miratimit. Punimet fillojnë vetëm pas lëshimit të aktit teknik. Heshtja nuk përbën miratim.

2/2. Procedura e thjeshtuar nuk zbatohet për ndërhyrjet strukturore, ndryshimet e vëllimit ose të pamjes, heqjen ose zëvendësimin e materialit historik ose të elementeve të dekorit, gërmimet arkeologjike ose ndryshimin e destinacionit. Për këto ndërhyrje zbatohen procedurat e zakonshme të

miratimit, sipas këtij ligji. Për masat minimale urgjente zbatohet neni 78 i këtij ligji. Kategoritë e punimeve të mirëmbajtjes që i nënshtrohen procedurës së thjeshtuar, kufijtë teknikë, dokumentacioni përkatës dhe mënyra e kontrollit të punimeve përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore".

3. Në fund të pikës 6 shtohet fjalia:

"6. Për pasuritë kulturore të paluajtshme, përshtatja funksionale shqyrtohet sipas nenit 77/1 të këtij ligji, pa cenuar kompetencat dhe procedurat për ndryshimin e destinacionit dhe dhënien në përdorim të pasurisë".

Neni 26

Në nenin 77 bëhen ndryshime dhe shtesa:

1.Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pasurive kulturore miratohet nga KKTKM-ja ose KKMPK-ja, sipas kompetencave përkatëse. Pasuritë kulturore të paluajtshme mund t'u nënshtrohen përshtatjeve funksionale dhe ndërhyrjeve arkitektonike për vijimin ose ndryshimin e përdorimit, rijetëzimin ose integrimin e tyre në projekte zhvillimi, kur sigurohet ruajtja e vlerave kulturore të mbrojtura, autenticitetit dhe integritetit të pasurisë. Përdorimi duhet të jetë i pajtueshëm me karakterin, kapacitetin dhe kushtet e sigurisë së pasurisë, pavarësisht nga pronësia dhe burimi i financimit."

2.Pas pikës 6 shtohen pikat 6/1 deri në 6/6 me këtë përmbajtje:

"6/1. Ndërhyrjet për përshtatjen funksionale mbështeten në një studim historik, arkitektonik dhe teknik. Studimi përcakton elementet që mbartin vlerat e mbrojtura, gjendjen e konservimit, si dhe mundësitë e ndërhyrjes. Studimi shqyrtohet nga KKTKM-ja përpara ose njëkohësisht me miratimin e projektit dhe nuk ndryshojnë statusin, objektin ose kufijtë e mbrojtjes ligjore së pasurisë.

6/2. Ndërhyrjet mund të përfshijnë përshtatjen e hapësirave, instalimet, përmirësimin e sigurisë, aksesueshmërisë dhe efiçencës energjetike, si dhe shtesa ose integrimin e elementeve të reja arkitektonike, në përputhje me pikën 6 të këtij neni. Në përcaktimin e ndërhyrjeve përparësi kanë ruajtja në vend, ndërhyrja minimale, ruajtja e materialeve historike dhe rikuperimi, kur është teknikisht e mundur. Ruajtja vetëm e elementeve të veçuara nuk është e mjaftueshme kur vlerat e mbrojtura lidhen me tërësinë e pasurisë ose me marrëdhënien ndërmjet elementeve të saj".

Neni 27

Në nenin 78, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Kur ekziston rrezik i menjëhershëm për jetën ose sigurinë e personave apo për dëmtimin e rëndë të pasurisë kulturore, pronari, poseduesi ose institucioni përgjegjës për administrimin e pasurisë mund të marrë masa urgjente, të përkohshme dhe të domosdoshme për sigurimin e saj dhe shmangien e rrezikut. DRTK-ja njoftohet menjëherë për masat e marra. Brenda 48 orëve nga marrja e tyre, DRTK-së i paraqitet dokumentacioni për gjendjen e pasurisë dhe masat e kryera. Masat urgjente kufizohen

në veprimet e domosdoshme për shmangien e rrezikut të menjëhershëm dhe nuk zëvendësojnë lejen për ndërhyrje sipas këtij ligji."

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 më këtë përmbajtje:

"1/1. Kur, pas marrjes së masave urgjente, nevojitet ndërhyrje e pjesshme ose e plotë në pasuri, DRTK-ja përcakton, sipas natyrës, gjendjes së pasurisë dhe kompleksitetit të ndërhyrjes, afatin brenda të cilit pronari, poseduesi ose institucioni përgjegjës për administrimin e pasurisë duhet të përgatisë projektin dhe preventivin përkatës. Pajisja me leje për ndërhyrjen e pjesshme ose të plotë kryhet sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj. Masat urgjente dhe përcaktimi i afatit nga DRTK-ja nuk zëvendësojnë dhe nuk përjashtojnë detyrimin për pajisjen me lejen përkatëse."

Neni 28

1.Në nenin 79, në fund të pikës 1 shtohet fjalia:

"Nga kërkesa për pajisjen me leje përjashtohen punimet e mirëmbajtjes që kryhen sipas pikës 2/1 të nenit 77 dhe masat minimale urgjente të parashikuara në pikën 1 të nenit 78 të këtij ligji."

2. Në pikën 7, fjalia e parë ndryshon si më poshtë:

"7. Punimet fillojnë brenda 1 viti nga data e miratimit të lejes për ndërhyrje. Për ndërhyrjet që, për shkak të natyrës, kompleksitetit ose kushteve të realizimit, kërkojnë një periudhë më të gjatë përgatitore, organi që miraton lejen mund të përcaktojë, në aktin e miratimit, një afat për fillimin e punimeve deri në 2 vjet, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mos cenohet gjendja e ruajtjes së pasurisë kulturore".

Neni 29

Pas nenit 83 shtohet neni 83/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 83/1

Restauratorët dhe mjeshtrit e teknikave tradicionale të ndërtimit

1. Personat që zotërojnë njohuri dhe aftësi praktike të dëshmuara në teknikat tradicionale të ndërtimit, të fituara nëpërmjet formimit profesional ose përvojës së dokumentuar, njihen dhe klasifikohen si mjeshtër të teknikave tradicionale të ndërtimit, sipas përcaktimeve të këtij neni.
2. Restauratorët dhe mjeshtrit e teknikave tradicionale të ndërtimit klasifikohen sipas nivelit të kualifikimit, përvojës profesionale, aftësive praktike dhe shkallës së specializimit. Për mjeshtrit e teknikave tradicionale të ndërtimit njihen edhe njohuritë dhe aftësitë e fituara nëpërmjet praktikës tradicionale.
3. IKTK-ja kryen vlerësimin dhe dokumentimin e njohurive dhe aftësive të restauratorëve dhe mjeshtrve të teknikave tradicionale të ndërtimit dhe krijon e administron Regjistrin Kombëtar të Restauratorëve dhe Mjeshtrve të Teknikave Tradicionale të Ndërtimit.
4. IKTK-ja organizon ose bashkërendon programe të formimit dhe zhvillimit profesional, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional dhe me institucione të

tjera të specializuara. Në këto programe mund të përfshihen edhe punonjësit e njësive të mirëmbajtjes pranë DRTK-ve.
5. Kategoritë e klasifikimit, kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të njohjes së njohurive dhe aftësive, si dhe mënyra e administrimit të regjistrit, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me propozimin e IKTK-së, në përputhje me legjislacionin për kualifikimet profesionale.
6. Njohja, klasifikimi dhe regjistrimi sipas këtij neni nuk zëvendësojnë licencat e kërkuara sipas këtij ligji për ushtrimin e veprimtarive të projektimit, zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të ndërhyrjeve në pasuritë kulturore materiale".

Neni 30

Në nenin 93 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. KKTKM-ja, në vendimin për miratimin e projektit dhe preventivit, sipas nenit 92 të këtij ligji, përcakton punimet dhe shpenzimet përkatëse që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e vlerave kulturore të pasurisë. Pjesa e shpenzimeve që përballohet nga buxheti i shtetit përcaktohet sipas këtij ligji. Angazhimi i fondeve publike kryhet nga autoriteti përgjegjës, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor. Vendimi i KKTKM-së nuk përbën angazhim buxhetor."

2. Pikat 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Shpenzimet në ngarkim të pronarit ose poseduesit përcaktohen mbi bazën e preventivit të miratuar dhe të shpenzimeve faktike, të dokumentuara dhe të verifikuara, duke zbritur kontributin publik financiar dhe në natyrë, sipas rastit. Përpara përcaktimit të detyrimit përfundimtar, pronarit ose poseduesit i vihet në dispozicion përllogaritja e shpenzimeve dhe dokumentacioni mbështetës dhe i caktohet një afat jo më i shkurtër se 15 ditë për paraqitjen e vërejtjeve."

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Vlera përfundimtare e shpenzimeve në ngarkim të pronarit ose poseduesit dhe afati për shlyerjen e tyre përcaktohen me urdhër të arsyetuar të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, mbi bazën e shpenzimeve të dokumentuara dhe të verifikuara sipas pikës 3 të këtij neni. Urdhri përbën titull ekzekutiv dhe mund të kundërshtohet në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit për gjykimin administrativ."

4. Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

"6. Dokumentacioni dhe procedurat për përllogaritjen, verifikimin dhe njoftimin e shpenzimeve, si dhe procedura për shqyrtimin e kërkesave për pagesën me këste, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat, në përputhje me legjislacionin në fuqi."

Neni 31

Në nenin 94, pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5, 6 me këtë përmbajtje:

"4. Kontributi publik për ndërhyrjet ruajtëse mund të jepet edhe në natyrë, nëpërmjet shërbimeve të dokumentimit, projektimit, asistencës teknike dhe profesionale, angazhimit të personelit të specializuar, si dhe vënies në dispozicion të mjeteve dhe materialeve të nevojshme. Ky kontribut dokumentohet dhe vlerësohet sipas metodologjisë së përcaktuar në zbatim të nenit 20/1 të këtij ligji dhe pasqyrohet në dokumentacionin teknik e financiar të ndërhyrjes.

5. Shpenzimet e mbuluara nëpërmjet kontributit publik financiar ose në natyrë, apo nga burime të tjera publike, nuk mund të financohen ose rimbursohen përsëri për të njëjtin qëllim. Institucioni publik përgjegjës evidenton veçmas kontributin publik dhe shpenzimet në ngarkim të pronarit ose poseduesit, në përputhje me nenin 93 të këtij ligji.

6.Mungesa e pronarit të identifikuar ose pasaktësia e të dhënave të pronësisë nuk pengon kryerjen e ndërhyrjeve të detyruara ruajtëse, sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj. Përcaktimi dhe ndjekja e detyrimeve financiare kryhen sipas nenit 93 të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi."

Neni 32

Në nenin 100, në fund të pikës 1, shtohet togfjalëshi "ose një person i deleguar prej tij".

Neni 33

Në nenin 101, në pikën 1, pas togfjalëshit "ministrit përgjegjës për trahsëgiminë kulturore" shtohet togfjalëshi "ose një person i deleguar prej tij".

Neni 34

Në nenin 112, pika 2, togfjalëshi "dhe zyrave të saj rajonale" hiqet.

Neni 35

Në nenin 116 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1.Veprimtaria tregtare e pasurive kulturore ushtrohet nga subjektet tregtare të licencuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet. Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) duhet të njoftojë menjëherë pas regjistrimit, ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe IKRTK për të dhënat e subjektit që licencohet si subjekt tregtar për tregtimin e pasurive kulturore. Pjesë e dokumentacionit, pranë QKB, për regjistrimin e subjekteve tregtare që duan të ushtrojnë veprimtari tregtare në fushën e pasurive kulturore është dhe deklarata që çdo subjekt duhet të nënshkruajë për përmbushjen e detyrimeve sipas dispozitave të këtij ligji përpara regjistrimit."

2. Pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

"10. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore nëpërmjet IKRTK-së njofton QKB, për inicimin e procedurave për mospërmbushjen e detyrimeve në mënyrë të përsëritur nga subjektet tregtare të licencuara. Nëse tregtari nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë ligj edhe pas zbatimit të

masave administrative, licenca revokohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore."

Neni 36

Pas nenit 120 , shtohet 120/1 me përmbajtje:

Neni 120/1

Vlerësimi i pasurive kulturore të paluajtshme për shpronësim ose blerje nga shteti

1. Vlerësimi i pasurive kulturore të paluajtshme në pronësi private, për qëllime të shpronësimit për interes publik, kryhet në përputhje me legjislacionin për shpronësimet. Në përcaktimin e vlerës së pasurisë, krahas vlerës së përcaktuar sipas metodologjisë së përgjithshme të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, merren në konsideratë karakteristikat e veçanta dhe vlerat kulturore të pasurisë, si dhe regjimi ligjor i mbrojtjes së saj.
2. Vlerat historike, arkitektonike dhe artistike, autenticiteti, gjendja e ruajtjes dhe karakteristikat e tjera të veçanta të pasurisë kulturore vlerësohen në mënyrë të posaçme dhe reflektohen në vlerën përfundimtare të pasurisë, sipas metodologjisë së përcaktuar në pikën 5 të këtij neni.
3. Vlerësimi kryhet nga vlerësues i licencuar i pasurive të paluajtshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për vlerësimin e karakteristikave dhe vlerave të pasurisë kulturore, vlerësuesi mbështetet në ekspertizën e institucionit të specializuar përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe, sipas rastit, të ekspertëve ose subjekteve të licencuara në fushën e trashëgimisë kulturore.
4. Në rastin e blerjes së pasurisë me marrëveshje nga shteti, vlerësimi sipas këtij neni shërben si bazë për përcaktimin dhe arsyetimin e çmimit të blerjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo dispozitë nuk cenon ushtrimin e së drejtës së parablerjes sipas këtij ligji.
5. Kriteret dhe metodologjia e posaçme për marrjen në konsideratë të karakteristikave dhe vlerave të pasurive kulturore të paluajtshme gjatë vlerësimit sipas këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për shpronësimet, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 37

Në nenin 125 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Për përcaktimin e vlerës monetare të objekteve pasuri kulturore të luajtshme, për të cilat kërkohet dalja pa kthim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, zyra për çështjet e import-eksportit pranë IKRTK-së mbështetet në udhëzimin e përbashkët mbi listën e çmimeve të referencës sipas vlerës së tregut, të miratuar nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministri përgjegjës për financat."

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

"7. Kushtet, procedura, formulari dhe dokumentacioni për lëshimin ose rinovimin e licencës së qarkullimit të lirë, në përputhje me nenin 125, pika 1 e këtij ligji, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore."

Neni 38

Në nenin 126, pika 1, emërtimi i zyrës për çështjet e eksportit zëvendësohet me emërtimin "zyra për çështjet e import-eksportit", duke përshtatur rasën përkatëse.

Neni 39

Në nenin 127, pika 2 riformulohet si vijon:

"2. Zyra për çështjet e import-eksportit, për shkak të vlerave të veçanta dhe/ose unike të pasurive për të cilat kërkohet licenca e qarkullimit të lirë, brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 125, të këtij ligji, për sa kohë nuk ka marrë vendim për lëshimin ose refuzimin e licencës, mund t'i propozojë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore blerjen e detyrueshme të pasurive për të cilat kërkohet licenca e qarkullimit të lirë, kundrejt një shpërblimi të drejtë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë."

Neni 40

1.Në nenin 128, pika 6 riformulohet si vijon:

"6. Licenca e qarkullimit të përkohshëm lëshohet nga titullari i IKRTK-së, në bazë të vendimit të zyrës për çështjet e import-eksportit. Licenca përmban afatin e qëndrimit jashtë vendit të pasurive të pajisura me licencën e qarkullimit të përkohshëm. Afati i qëndrimit të pasurive jashtë vendit nuk mund të jetë më shumë se 18 muaj nga dalja jashtë territorit."

2.Në nenin 128 pas pikës 12 shtohet pika 13 me këtë përmbajtje:

13. Kushtet, procedura, formulari dhe dokumentacioni për lëshimin ose rinovimin e licencës së qarkullimit të përkohshëm, në përputhje me nenin 125 të këtij ligji, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 41

Në nenin 129 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.Pas pikës 1 të nenit, shtohen pikat "1/1", "1/2 "dhe "1/3" me këtë përmbajtje si vijon:

"1/1. Hyrja e disa kategorive të pasurive kulturore të vendeve të tjera, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në përputhje me pikën 6 të këtij neni, lejohet vetëm kundrejt lëshimit, paraprakisht, të:
a) licencës së importit nga zyra kompetente, pranë IKRTK, me kërkesë të subjektit të interesuar;
b) apo me anë të një deklarate të importuesit të objekteve kulturore si pjesë e deklaratës doganore në përputhje me Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.
1/2. Pika 1/1 e këtij neni nuk zbatohet për:

a) objektet kulturore që janë objekte të kthyera në kuptim të nenit 185 të Kodit Doganor të R.SH;
b) importi i objekteve kulturore me qëllim ekskluziv të sigurimit të ruajtjes së tyre nga ose nën mbikëqyrjen e një autoriteti publik, me synimin për t'i kthyer objektet kulturore, kur situata e lejon;
c) pranimin e përkohshëm të objekteve kulturore, në kuptim të nenit 223 të Kodit Doganor, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për qëllime edukimi, shkencore, konservimi, restaurimi, ekspozimi, digjitalizimi, performimi, kërkime të kryera nga institucione akademike ose bashkëpunim midis muzeve ose institucioneve të ngjashme;
1/3. Nuk kërkohet licencë importi për objektet kulturore që janë vendosur nën procedurën e lejimit të përkohshëm në kuptim të nenit 223 të Kodit Doganor, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, kur këto objekte do të paraqiten në panairet tregtare të artit. Në raste të tilla, duhet të sigurohet një deklaratë nga importuesi në përputhje me procedurën në pikën 1/1 të këtij neni.

2.Pika 2, riformulohet si vijon:

"2. Kërkesës për lëshimin e licencës së importit të parashikuar në pikën 1 dhe shkronjën "a" të pikës 1/1 të këtij neni, i bashkëlidhet dokumentacioni i nevojshëm për identifikimin e pasurisë dhe të vendit nga i cili vjen. Për këtë qëllim, subjekti i interesuar duhet të depozitojë:

a) Dokumentacionin identifikues të pasurisë kulturore, të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës;

b) Dokumentacionin provues dhe identifikues të prejardhjes së saj nga vendi që vjen;

c) Dokumentacionin që ka lejuar daljen e pasurisë kulturore nga ku është krijuar (vendi i origjinës) ose zbuluar në përputhje me ligjet dhe rregulloret e atij vendi."

3.Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

2/1 Dokumentet që provojnë vendin e origjinës për objektet kulturore të importuara janë:

a) një deklaratë e nënshkruar nga mbajtësi i objekteve që deklaron se objektet kulturore janë eksportuar nga vendi ku janë krijuar ose zbuluar në përputhje me ligjet dhe rregulloret e atij vendi në kohën kur janë nxjerrë jashtë territorit të tij;

b) një dokument të standardizuar nga IKRTK, që përshkruan objektet kulturore me detaje të mjaftueshme në mënyrë që ato të identifikohen;

c) Si përjashtim të pikës (a), në vend të kësaj deklarate, importuesi mund të deklarojë se objektet kulturore janë eksportuar në përputhje me ligjet dhe rregulloret e vendit të fundit ku ato kanë qenë të vendosura për një periudhë prej më shumë se 5 (pesë) vjet dhe për qëllime të ndryshme nga përdorimi i përkohshëm, tranziti, rieksporti ose transferimi, në rastet e mëposhtme:

i. vendi ku u krijuan ose u zbuluan objektet kulturore nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme; ose

ii. objektet kulturore janë nxjerrë jashtë vendit ku janë krijuar ose zbuluar përpara hyrjes në fuqi të Konventës së UNESCO-s të vitit 1970 "Mbi mjetet e ndalimit dhe parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore".

4.Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

"7. Kategoritë, kushtet, afati, mënyra, procedura dhe forma për lëshimin, rinovimin apo refuzimin e licencës së importit për pasuritë kulturore të parashikuar në pikën 1/1 si dhe ato për të cilat kërkohet

vetëm deklarata e importuesit, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.”

Neni 42

Në nenin 130, pika 2, togfjalëshi *“sipas pikës 5”* zëvendësohet me togfjalëshin *“sipas pikës 4”*.

Neni 43

Në nenin 131, pas pikës 2 shtohen pikat 3-16 me këtë përmbajtje:

"3. Organet kompetente në Republikën e Shqipërisë:

a) ju mundësojnë organeve kompetente të shtetit kërkues, të kontrollojnë nëse objekti është pasuri kulturore, me kusht që kontrolli të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e njoftimit. Në qoftë se ky kontroll, nuk ushtrohet nga ana e shtetit të njoftuar brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e njoftimit, organet kompetente në Republikën e Shqipërisë nuk kanë detyrimin për të respektuar shkronjat b) dhe c) të këtij neni;
b) marrin çdo masë të nevojshme, në bashkëpunim me shtetin në fjalë, për ruajtjen fizike të objekteve kulturore;
c) parandalojnë, me masa të përkohshme të nevojshme, çdo veprim për të shmangur procedurën e kthimit;
ç) veprojnë si ndërmjetës midis poseduesit dhe/ose mbajtësit të pasurisë kulturore dhe shtetit të cilin dyshohet se i përket objekti kulturor i trafikuar, në lidhje me rikthimin e tij në vendin e origjinës.
4. Procedura e kthimit të objekteve pasuri kulturore të trafikuara në mënyrë të paligjshme, në përputhje me dispozitat e këtij ligji nuk mund të fillojë më vonë se 3 (tre) vjet, pasi organi qendror kompetent i shtetit kërkues, ka marrë dijeni për vendndodhjen e objektit kulturor dhe për identitetin e poseduesit ose mbajtësit të tij.

5. Një procedurë e tillë, nuk mund të fillojë më vonë se 30 (tridhjetë) vjet pasi objekti është trafikuar në mënyrë të paligjshme nga territori i shtetit kërkues.

6. Në rastin e objekteve që janë pjesë e koleksioneve publike dhe objekteve që i përkasin inventarëve të institucioneve fetare në shtetet ku ato i nënshtrohen rregullimeve të veçanta të mbrojtjes sipas ligjit kombëtar, procedurat e kthimit do t'i nënshtrohen një afati kohor prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) vjetësh, me përjashtim të shteteve, ku procedurat nuk i nënshtrohen një afati kohor ose në rastin e marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të njoftuar që parashikojnë një periudhë më të madhe se 75 (shtatëdhjetë e pesë) vjet.

7. Procedura e kthimit nuk mund të fillojë nëse largimi i pasurisë kulturore nga territori i shtetit kërkues nuk ishte i paligjshëm në kohën kur u krye.

8.Institucionet përgjegjëse të cilat kryejnë dhe koordinojnë procesin e rikthimit të objekteve të trafikuara në mënyrë të paligjshme, janë ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive Kulturore.

9. Shteti kërkues ka të drejtë të paraqesë padi për kthimin e pasurisë kulturore të larguar në mënyrë të paligjshme, kundër poseduesit ose, në mungesë të tij, mbajtësit, pranë gjykatës kompetente në

Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit procedural në fuqi. Padisë i bashkëlidhen dokumenti që përshkruan pasurinë kulturore dhe vërteton cilësimin ose klasifikimin e saj sipas legjislacionit të shtetit kërkues, si dhe deklarata e autoritetit kompetent të këtij shteti se largimi ka qenë i paligjshëm.

10. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në bashkëpunim me IKRTK-në, njofton pa vonesë autoritetet kompetente të shteteve të interesuara për fillimin e procedurës së kthimit, kur merr dijeni për të, si dhe lehtëson shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. Gjykata vendos kthimin e pasurisë kulturore kur vërtetohet se ajo përfshihet në fushën e zbatimit të këtij neni dhe është larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i shtetit kërkues, përveç rasteve kur kërkesa është e parashkruar ose largimi nuk është më i paligjshëm në kohën e shqyrtimit të kërkesës.

12. Me vendimin që urdhëron kthimin, gjykata cakton kompensim të drejtë për poseduesin vetëm kur ai provon se ka ushtruar kujdesin e duhur gjatë fitimit të pasurisë. Në vlerësimin e kujdesit të duhur merren parasysh të gjitha rrethanat e fitimit, veçanërisht dokumentacioni mbi prejardhjen, autorizimet e eksportit të kërkuara sipas ligjit të shtetit kërkues, cilësia e palëve, çmimi i paguar, konsultimi i regjistrave të aksesueshëm të pasurive kulturore të vjedhura dhe çdo informacion tjetër që një person i arsyeshëm mund të kishte siguruar.

13. Kur pasuria kulturore është fituar me trashëgimi ose dhurim, poseduesi nuk gëzon të drejtë më të favorshme për kompensim sesa personi nga i cili e ka fituar atë. Kompensimi i drejtë, kur caktohet, paguhet nga shteti kërkues në momentin e kthimit të pasurisë kulturore.

14. Shpenzimet e ekzekutimit të vendimit të kthimit, si dhe shpenzimet e masave të ruajtjes dhe të masave të përkohshme të ndërmarra për sigurimin e kthimit, përballohen nga shteti kërkues, pa cenuar të drejtën e tij për të kërkuar rimbursimin nga personat përgjegjës për largimin e paligjshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

15. Pronësia mbi pasurinë kulturore pas kthimit rregullohet nga legjislacioni i shtetit kërkues.

16. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë të drejtën e shtetit kërkues ose të pronarit për të përdorur mjete të tjera juridike, civile ose penale, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi."

Neni 44

Në nenin 224, pika 3 riformulohet si vijon:

"3. Kërkesa e muzeut publik për pasurim të fondit muzeor dhe dokumentacioni shoqërues paraqitet pranë IKRTK-së. Kërkesa për pasurim të fondeve muzeore, e paraqitur nga ana e muzeve publikë dhe privatë, shqyrtohet dhe miratohet nga Këshilli Kombëtar i Muzeve, pas marrjes së mendimit paraprak nga IKRTK."

Neni 45

Në nenin 259, pika 3 shfuqizohet.

Neni 46

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "*Fletoren zyrtare*".